

Rruga Aleksandër Moisiu nr.78  
Kinostudio  
Tirana, Albania 1005  
T +35542365188  
F +35542365157  
W [www.ihrffa.net](http://www.ihrffa.net)  
@ [info@ihrffa.net](mailto:info@ihrffa.net)

# IHRFFA

International Human Rights  
Film Festival Albania

NR 212 PROT.  
Dt. 25-04-2018

Tiranë, me 24 Prill 2018

Prot Nr. 84

Drejtuar: Qendrës Kombëtare e Kinematografisë

I nderuar zoti Kryetar Ilir BUTKA,

Krejt rastësisht morëm dijeni nëpërmjet Facebook për projektet e festivaleve të filmit të miratuara nga ana e Këshillit të Miratimit të Projekteve në QKK.

Akademia e Filmit dhe Multimedias MARUBI, cilësohet edhe si partnere e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në faqen zyrtare të QKK, të AFMM, dhe të IHRFFA. Që prej vitit 2006, organizojmë Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Sivjet do të mbahet edicioni i 13 i IHRFFA.

Çuditërisht, sivjet, pamvarësisht kërkimit dhe përditësimit të vazhdueshëm në faqen zyrtare të QKK për njoftimet në lidhje me thirrjen për aplikime për projekte dhe festivale, nuk kemi arritur të gjejmë një njoftim të tillë. Për këtë arsye, nuk kemi dorëzuar aplikimin tonë, dhe vetëm sot vihemi përpara faktit të kryer. Shohim edhe publikimin e programit të transparencës që keni publikuar në faqen e QKK, ku në një sërë rubrikash i referoheni informacionit i cili publikohet pa kërkesë të veçantë. Njëkohësisht, figurojnë në rrjet dy faqe zyrtare të QKK, secila me informacion jokohorent dhe kontradiktor. (<https://nationalfilmcenter.wordpress.com/> <http://nationalfilmcenter.gov.al/>)

Ndërkohë mungon një informacion shumë i rëndësishëm; ai njoftimeve për thirrje aplikimesh, i cili është informacion detyrues për t'u publikuar dhe për të qenë lehtësisht i aksesueshëm nga publiku dhe nga të interesuarit.

Programi i transparencës rezulton të jetë një format tejet formal, i cili nuk përmban informacione kyçe për të cilat janë të interesuar partnerët. Kjo, lidhet ngushtësisht edhe me transparencën e procesit të shpërndarjes së fondeve publike nga QKK për projektet.

Nga ana tjetër, ne si (OraFilm) Akademi e Filmit dhe Festivali i Filmit njoftohemi nga QKK për aktivitete, thirrje për aplikime, e për projekte të tjera, ndërkohë që për mbledhjet e KMP-ve, nuk na vjen asnjë njoftim që prej vitit 2012. Për më tepër, duke ju konsideruar partnerë të IHRFFA, ne ju kemi dërguar rregullisht e-maile informues për takimet e Bordit të Partnerëve që



# IHRFFFA

International Human Rights  
Film Festival Albania

janë mbajtur edhe këtë vit me partnerët tanë, pavarësisht se nga QKK nuk ka ardhur asnjë përgjigje apo përfaqësues.

Zoti Butka,

Sa më lart, vë në vështirësi egzistenciale, IHRFFFA-n.

Shpresojmë që politikat përjashtuese janë të rastësishme dhe jo dashakeqëse, ndaj kërkojmë rimbledhjen e KMP-së për të marrë në shqyrtim projektin e IHRFFFA 13, të cilin e kemi gati ta dorëzojmë sapo të marrim njoftim nga ju.

Me respekt  
Kujtim CASHKU  
Drejtor Egzekutiv  
IHRFFFA

